



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2242 Prot

Shkodër, me 15.06 2026

V E N D I M

Nr. 178 datë 15 . 06 2026

"PËR MIRATIM TË RIMBURSIMIT TË TARIFËS SË TITULLIT "PROFESOR I ASOCUAR" PJESE E STAFIT AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË "TË USH-së

Në mbështetje të Ligjit të AL me nr.80/2015 datë 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", neni 3, pika 3,germa c; neni 95,neni 98, pika 3;neni 108, pika 4; Ligjit nr.44/2015 "*Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë*"; VKM nr.75 datë 12.02.2018 "*Për miratimin e modelit të financimit të Institucioneve Publike të AL*", IV; Vendimit nr.879 datë 18.12.2019 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41 datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave "*Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL*"pika 2.12, germa a; Statutin e USH-së neni 5,pika 3; neni 17; neni 56 pika 3,neni 58 pika 4;me kërkesën datë 20.05.2026 nga Benjamin Naku, pjese e stafit akademik me kohë të plotë në USH-së, Fakulteti i Shkencave të Edukimit ,departamenti i Edukimit Fizik dhe sportive, Bordi i Administrimit ne mbledhjen e dates 15.06.2026, me 4 vota pro dhe 3 kunder

VENDOSI:

1. Miratimin e rimbursimit të tarifës së detyruar të marrjes së titullit "Profesor i asocuar"me vlerën 350.000(treqind e pesëdhjetë mijë)lekë, për z. B.Naku, pjese e stafit akademik me kohë te plotë"të USH-së,në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve.
2. Fondi të merret nga të ardhurat e institucionit.
3. Ky vendim i përcillet Administratorit të USH-së për zbatim.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëhere.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Prof. Asoc.Dr. Adrian Leka

